



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Ured Ministra Pravde – Office of Minister of Justice

Nr. 86 /2022
Datë: 20/05/2022

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr.7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, (30.03.2021), e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren QRK-Nr.04/2021 (10.09.2021), në bazë të nenit 24/B, paragrafi 4 të Rregullores QRK-Nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-Nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në përputhje me nenin 44 dhe nenin 53 (paragrafi 1 dhe 3) të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit nr. 96/2020, dt. 03/11/2020

1. Znj. Pranvera Ejupi - Hajzeraj, **LIROHET** nga detyra e Udhëheqëses së Divizionit për koordinimin e procesit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në kuadër Ministrinë e Drejtësisë.
2. Shfuqizohet vendimi nr. 96/2020, dt. 03/11/2020, me të cilin znj. Pranvera Ejupi - Hajzeraj është emëruar Udhëheqëse e Divizionit për koordinimin e procesit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Obligohet Divizioni për Burime Njerëzore dhe Divizioni për Buxhet dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Znj. Pranvera Ejupi Hjazera me Vendimin Nr. 96/2020, dt. 03/11/2020, ishte caktuar Udhëheqëse e Divizionit për koordinimin e procesit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Sipas nenit 24/B, paragrafi 2 të Rregullores QRK-Nr. 12/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK-Nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Udhëheqësi/ja e Divizionit për koordinimin e procesit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në kuadër Ministrinë e Drejtësisë, për çështjet operationale raporton te Ministri/ja e Drejtësisë. Për më shumë, përgjegjësitë dhe detyrat në kuadër të Divizionit janë të përcaktuara me nenin përkatës (24/B).

Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të saj, Udhëheqësja e Divizionit për koordinimin e procesit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në mënyrë të përsëritur nuk i është përmbajtur obligimeve që rrjedhin nga përgjegjësitë e angazhimit të saj duke tejkuluar kompetencat dhe gjithashtu, duke raportuar në mënyrë ta pasaktë.

Raportimi i pasaktë dhe tejkalimi i kompetencave, bie ndesh me rregulloren përkatëse dhe legjislacionin në fuqi dhe për arsytet e tilla, u vendos si në dispozitiv të vendimit.


Albëdina HAXHIU
Ministër e Drejtësisë

Vendimi i'u dërgohet:

- Znj. Pranvera Ejupi - Hajzeraj;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm/MD;
- Divizionit për Burime Njerëzore/MD;
- Divizionit për Buxhet dhe Financa/MD;
- DKPMJMFPAAPPGjDhS/MD;
- Arkivit të MD-së.